

RREGULLORE E KONKURRIMIT

Për pjesëmarrjen në Festival - 2026

Kënga konkurruese për pjesëmarrje në festival duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Kënga duhet të jetë e kënduar në gjuhën shqipe.
2. Kënga nuk duhet të jetë më e gjatë se 4 (katër) minuta.
3. Kënga nuk duhet të jetë publikuar më parë në asnjë formë.
4. Kënga duhet të jetë krijim origjinal i autorëve dhe nuk duhet të jetë krijuar me AI (Inteligjencë Artificiale).
5. Artisti interpretues (këngëtari), si dhe autorët e këngës (kompozitori, poeti dhe orkestruesi), duhet të jenë shqiptarë.
6. Artistët interpretues (këngëtarët) duhet të jenë mbi 18 vjeç.
7. Një artist interpretues, në cilësinë e këngëtarit, mund të marrë pjesë në festival vetëm me një (1) këngë.
8. Një autor i kompozimit muzikor mund të marrë pjesë në festival me jo më shumë se një (1) kompozim muzikor (këngë), duke përfshirë në këtë numër edhe bashkëautorësitë në këtë cilësi (d.m.th. si kompozitor).
9. Një autor teksti mund të marrë pjesë në festival me jo më shumë se dy (2) tekste, duke përfshirë në këtë numër edhe bashkëautorësitë në këtë cilësi (d.m.th. si autor teksti).
10. Një orkestrues mund të marrë pjesë në festival me jo më shumë se dy (2) orkestrime, duke përfshirë në këtë numër edhe bashkëautorësitë në këtë cilësi (d.m.th. si orkestrues).

Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme sjell përjashtimin e këngës nga konkurrimi për pjesëmarrje në Festival.

DORËZIMI I KËNGËVE KONKURRUESE

Dorëzimi i këngëve konkurruese do të bëhet nëpërmjet aplikimit në faqen zyrtare të Radio Televizionit Shqiptar, në datat:

22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 Shtator 2026